

E QESHURA QË ÇARMATOSI PERËNDITË

Fatmir SULEJMANI¹

¹Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

¹Corresponding author e-mail: fatmir.sulejmani@unite.edu.mk

Abstrakt

Kumtesa me titullin *E qeshura që çarmatosi perënditë* mëton të hedhë dritë mbi: vlerat estetike të romanit *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* të Dritëro Agollit - njërës prej veprave më të lexuara dhe më disidente të kohës së realizmit socialist, jo vetëm në Shqipërinë komuniste por edhe në gjithë bllokun komunist evropian; kohën dhe rrethanat në të cilat u botua, në kushtet e një shoqërie rreptësisht të kontrolluar; heronjtë dhe dukuritë atipike të veprës; mënyrën e sfidimit të rregullave dhe kornizave të ngushta zhdanoviste dhe pritjen e romanit nga lexuesit shqiptarë dhe të huaj.

Fjalët kyçe: *Shoqëria, rrethanat, perseonazhet, komunizmi.*

Prolog

Në studimin mbi dukuritë atipike të veprës së Dritëro Agollit, profesor Shaban Sinani thotë: “*Shkruar në kushtet e një shoqërie rreptësisht të kontrolluar, për t’u lexuar, si çdo letërsi tjetër, edhe në kushtet e shoqërisë së hapur, letërsia e realizmit socialist nuk mund t’i shmanget pyetjes nëse brenda saj ka njerëz të vërtetë, që zhvillohen në mënyrë të pavarur prej ideologjisë sunduese*”.¹

Por, sado e shtruar që në kapërcyell sistemesh, pyetja e profesorit të njohur nuk e ka marë akoma përgjigjen e plotë, sepse disa studiues të letërsisë vazhdojnë t’i qasen asaj me gjykime të errësuar jashtëletrare, duke i barazuar krijuesit mediokër me shkrimtarët me autoritet ndërkombëtar, madje duke i konsideruar këta të fundit si inspirues të dogmave të realizmit socialist. Natyrisht, askush nuk e mohon të dhënë se, në tërësinë e saj, metoda e realizmit socialist ka qenë direktivë e indoktrinuar pushtetare, që artin e shihte në funksion të armës ideologjike, metodë që favorizoi autorët e partishëm dhe konformistë me mungesë të theksuar talenti, skribomanët që e shfrytëzuan atë si mburojë të shterpësisë.

Nuk e mohon kush as të vërtetën se, asokohe, në ballë të luftës me armiqtë e sistemit pati shkrimtarë që me ekspertiza policore çuan pa pikë faji para xhelatëve poetë të rinj si: Vilson Blloshmi, Genc Leka, Havzi Nela... Megjithatë, duhet pranuar se, pati dhe krijues që nuk e përfillën artin pragmatik të imponuar nga lart. Sigurisht, pati dhe *disidencë estetike* nëpërmjet veprave si: “*Përbindëshi*” apo “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*”..., të sfidantëve të kornizave të ngushta të krijimtarisë, gjë që është vërejtur me kohë edhe prej kritikës perëndimore. Pikërisht gjetja e gjurmëve të këtij lloji të disidencës në krijimtarinë e kohës së monizmit, që, natyrisht, nuk mund të barazohet me disidencën e një Aleksandër Shollzenjicini, Josif Brodski (Rusi), Milan Kundera (Çekosllovakia), Cesllav Milloshi (Poloni)..., përcaktoi objektin e këtij studimi - romanin “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*” të Dritëro Agollit, që, për shumëkë, shkundi

¹ Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, f. 266.

themelet e ngrehinës zhdanoviste². I përmenda disidentët e pjesës komuniste të Evropës, sepse krijuesit e ekskomunikuar dhe të likuiduar shqiptarë, si: Musine Kokalari, Trifon Xhaxhika e ndonjë tjetër, konsiderohen më shumë si kundërshtarë të monizmit se sa si disidentë.

Koha dhe rrethanat e botimit të romanit

Romani *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* u botua në vitin 1973, në kohën kur arti kërkonte me ankth mekanizmat shprangosës prej çmendurisë së pragmatizmit që mbahej në këmbë nga mizëria e shkrimtarëve, kritikëve dhe studiuesve obortarë, kësaj pararoje të devotshme të luftës së klasave dhe revolucionit të përcudnuar kulturor, të ngritur mbi fatkeqësi krijuesish të njëmendtë, të cilët, sa herë e gjenin udhën e shmangies së shabloneve të imponuara, detyroheshin t’u përgjigjen me autokritika fletë-rrufeve të mashave pushtetare.

Këto pra qenë rrethanat në të cilat u botua romani i Dritëroit, me një çift interesant heronjsh letrarë (shëfin dhe vartësin e tij), të cilin akademik Ali Aliu e krahason me çiftin monumental të letërsisë botërore - Don Kishotin dhe Sanço Pançon e Servantesit.³ Për njohësit e stalinizmit shqiptar mbetet i pasqarueshëm guximi i autorit, i cili pikërisht në fazën e forcimit të voluntarizmit, nëpërmjet kuadrove të kulturës masive, të ngarkuar për disiplinimin e artit, vuri në lojë kreun e paaftë të shtetit, i ndërgjegjshëm se mund ta rrezikojë seriozisht vetveten. Ngritja e tij e hapur kundër zhdanovizmit, eliminon dilemat e lexuesve rreth përvjedhjeve rastësore të goditjeve me të cilat autori e përçmon pushtetin e ngritur mbi mekanizma dhune.

Të vetmen gjë që bëri për të shmangur persekutimin e frikshëm, është goditja me këste e ligësive të sistemit, zbutja e sfidës nëpërmjet humorit, kamufli i saj si *“rastësi e izoluar”*, tiparet prej loloje të shokut Zylo, vënia e tij në pozita qesharake, që, si gjetje *“...është një prej zbulimeve të lashta të letërsisë”*⁴. Guximin prometean, *“ndërmarrjen donkishoteske dhe gati të frikshme..., që preku dukuritë më karakteristike të pushtetit dhe diktaturës komuniste të kohës...”*⁵ e dëshmon vetë autori, që, diku në fillim të romanit, shkruan: *“Nuk ka asgjë më të keqe se ta vesh njeriun në pozita qesharake. E qeshura e çarmatos njeriun. Aristofani me të qeshurat i çarmatosi perënditë”*.⁶

Pa dyshim, kjo shpërfaq qëllimin e vërtetë të shkrimtarit të arritur nëpërmjet humorit dhe të qeshurës, e bën katërcipërisht të qartë ç’perëndi deshi të çarmatosë ai dhe e forcon bindjen se, në kulmin e histerisë staliniste, Dritero Agolli shkroi një vepër të guximshme me tipare disidence, të konsideruar prej shumëkujt ndër më rebelët në gjithë kampin socialist. Jo rastësisht, njëri prej pushtetarëve më të lartë dhe më të frikshëm të Shqipërisë staliniste Mehmet Shehu, me një rast i thotë Dritëroit: *“Nuk të kam thënë gjer tani, se të kam mik, por me atë Zylon tënd ma ke bërë qesharake administratën!”*

Bota e romanit

² Zhdanovizmi lindi në Bashkimin Sovjetik. Ai e mori emrin e ideatorit të tij Andrei Zhdanov, i njohur si shpikës i parimeve të realizmit socialist, të ngjizura me ideologjinë socialiste, që i shndërroi artistët në punonjës shteti dhe në *“inxhinierë të shpirtërave”*, i ngarkoi ata me detyrën e njohjes së popullit, me nevojën e shpërfaqjes së realitetit jetësor përgjatë procesit të zhvillimit revolucionar dhe me obligimin që, nëpërmjet veprave të artit, të edukojnë masat në frymën e revolucionit.

³ Ali Aliu, *Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*, Zemra Shqiptare, 20.10.2010.

⁴ Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, f. 272

⁵ Ali Aliu, *Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*, Zemra Shqiptare, 20.10.2010.

⁶ Dritëro Agolli, *Shkëlqimi dhe rënja e shokut Zylo*, Rilindja, Prishtinë, f. 30

Bota e romanit “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*” është Shqipëria e periudhës staliniste, pjella e revolucionit që hante fëmijët e vet, pararoja e komunizmit botëror, ku bashkëjetonin monstat e revolucionit kulturor dhe populli që shtirrej i lumtur, sepse rrugë tjetër nuk i kishin lënë. Brenda kësaj bote të vogël kurtoaze dhe plot falcitet, të aftit rrinin nën hijen e diletantëve me pushtet, shkrimtarët harronin të shkruajnë, kurse injorantët bënë karrierë artistësh me dekorata presidenciale. Është kjo bota stereotipe, monotone, njëdimensionale, e pandryshueshme, e vetëmjaftueshme..., ku gjithë njerëzit janë të njëjtë, duken njësoj, vishen njësoj, këndojnë të njëjtat këngë, shkruajnë të njëjtin libër, portretojnë të njëjtën botë bardh-e-zi, lindin dhe vdesin njësoj brenda ferrit dhe parajsës monoforme komuniste.

Është një botë plot sanço-paço e mbetur pa prometejë, ku rritet rasati i kultit të baballarëve të kombit, që përveçse prijës të revolucionit ishin dhe inxhinierët e shpirtit të robit dhe arkitektët e të ardhmes prej ferri, detyra e të cilëve ishte mpakja e ndërgjegjes së njerëzve të mpirë me narkozë ideologjike dhe mbjellja e halucinacioneve që jetën mizerje e shndërrojnë në parajsë engjëjsh të hareshëm, ku s’ka vend për keqbërës, lypsarë, fatprerë dhe shpirtrobër... Në këtë parajsë ku njerëzit nuk njohin Zot tjetër përveç faraonit, partisë dhe punës, edhe arti është ndryshe prej pjesës tjetër të botës, sepse ai është art proletar, i krijuar prej artistëve të shkrirë në magmën e epigonëve në shërbim të pushtetit.

Në një sistem të këtyllë nuk ekzistojnë shkallë hierarkike vlerash kulturore, letrare, shkencore... Aty ka vetëm padronë të frustruar privilegjesh dhe vartës kokëunjur, pa të drejtë mendimi e fjale. Aty gjithçka është dyngjyrëshe, si nata me ditën. Miqësia e sinqertë ndërmjet njerëzish është pothuajse kategori e panjohur, natyrisht: nëse nuk konceptohen për të tilla lidhjet ndërmjet punëdhënësit dhe shërbëtorit, që mbarojnë posa pushon mandati i të parit, sepse njeriu vlen për aq kohë sa ka pushtet.

Sistemi në fjalë është i pabesë. Shtyllat e tij janë spiunët dhe shpifarakët. Rregullat e mbijetesës kërkojnë që askush askujt mos t’i besojë. Është kjo zeja e të gjithëve, pa asnjë përjashtim. Pushtetarët e shfrytëzojnë për ngritje në karrierë, kurse njerëzit e thjeshtë për çështje mbijetese dhe për shkak të frikës së futur në palcë. Viktimat e revolucionit, ndërkaq, edhe kur gjenden përpara skuadrave të pushtetit, për fjalë të fundit zgjedhin: *Të rrojë partia!* E mos të flasim për prometejë qirinjë të Atdheut, që rrezikonin të mbeten edhe pa varr...

Këto copëza jete, Dritëroi i portretoi me skenime të përpikta, i ironizoi duke lëvizur nëpër tehun e shpatës që mund t’ia priste kokën, gjë që më së miri e ka përkufizuar studiuesi i madh Alen Boske, që, pas leximit të veprës, e quajti atë *dinamit të mbuluar me petale*. Është kjo koha kur njerëzit e papërshtatshëm të sferës së kulturës dhe të artit zëvendësoheshin me krijues të meseve rurale, kur gjithçka zhvillohej sipas direktivave të specialistëve sovjetikë, të cilët sollën në Shqipëri rregullat që do të ndiqnin artet dhe letërsia në veçanti. Kjo mendësi e ngritur mbi frikën e armiqve imagjinarë të shtetit, pas vitit 1973 humnerosi përfundimisht shpresën për shprangimin e shpirtit krijues dhe lulëzimin e mëtejshëm të ndonjëfarë frymeje liberale.⁷

Bartësit e ideve ngulfatëse e quajtën modernizmin *degjenerim të kulturës*, *art dekadent borgjez*..., që ndot artin e pastër socialist. Dritëroi Agolli si duket e shfrytëzoi me zgjuarësi periudhën e shkurtë të liberalizmit të ndrojtur në sferën e kultures, në fund të viteve të ’60-ta, për ta shkruar romanin e tij rebel, duke i dhuruar letërsisë njërën ndër dëshmitë me interesante estetike të kohës, para se të nisë epoka e një mesjete të re për artin dhe artistët shqiptarë, para

⁷ Gjatë viteve ’69-’73 në Shqipëri pati një frymë liberale në sferën e kulturës dhe artit, që rezultoi me krijimin e një morie veprash të arrira në të gjitha llojet e artit. Mjerisht, kjo u ndërpre pas Plenumit të IV të KQ të PPSH-së, me moton: “*Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre*”.

nisjes së ndëshkimeve të rënda të sabotuesve të pastërtisë ideologjike. Përndryshe, kundërthëniet ndërmjet pushteteve dhe artistëve kanë qenë të njëjlojta që nga zanafilla e arteve.

Megjithatë, pasoja më të frikshme kanë përjetuar krijuesit e sistemeve totalitare, si puna e Shqipërisë komuniste, që ekskomunikoi, dënoi rëndë madje likuidoi një numër të madh krijuesish, arti i të cilëve ra ndesh me vijën ideologjike të partisë në pushtet. Pikërisht për këtë, emra eminentë studiuesish shqiptarë dhe të huaj, kanë thënë se veprën “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylu*” Agolli e shkruajti me guximin e një të marri, duke sfiduar metodën e realizmit socialist dhe duke çarmatosur perënditë e pushtetit, nëpërmjet të qeshurës së Aristofanit dhe humorit që zbuti dhe relativizoi pasojat e rënda, që mund t’i binin mbi kokë.

Heronjtë e romanit

Dritëro Agolli është ndër shkrimtarët e rrallë që ka krijuar personazhë të pavdekshëm, si Zylu Kamberi dhe Demka.

Shoku Zylu përfaqëson kuadrin kallp të të gjitha sferave të jetës. Ai është prototip heroit të cilin e gjejmë në jetën reale të regjimeve satrape, ku zylokamberat janë shkronja e parë dhe e fundit e alfabetit të jetës. Zylua merret me probleme të mëdha shoqërore e që s’ka nge të humbë kohë me vogëlsira. Ai është specialist për art dhe letërsi, drejtues i sektorit të kulturës masive. Është mediokër me pushtet të pamerituar, i squllët ndaj eprorëve dhe i sertë ndaj vartësve. Zylua ka karakter të luhatshëm dhe mungesë krenarie. Karrierën ia ka borxh dashurisë që ka për të shoku Q, sepse sistemi i hurit e litarit nuk njeh pozita të tjera pos atyre të mbështetura në akraballëk.

Ai lavdërohet se ka botuar një artikull të rëndësishëm mbi zhvillimet kulturore të vendit, pa çka se, pa ndihmën e Demkës, nuk është i aftë të përgatisë as fjalimet edhe raportet që lexon në mbledhjet e rëndësishme. Paaftësia nuk e pengon t’i bëjë vërejtje edhe *Historisë së Shqipërisë*, sepse pushteti i ka dhënë të drejtën të pandehë se është njohës i më shumë fushave të dijes. I gjendur në pozitën e drejtuesit të kulturës masive, ai betohet se do të vendosë rregull në rrëmujën e krijuar nga koha kur sektorin e drejtonte rivali i tij Shemshedini.

Nganjëherë e kupton se është snob që duhet të aktrojë madhështinë e rreme; që duhet të shtirret se lexon shumë dhe gjoja nuk dëshiron të shkojë në pushime shkaku i obligimeve të shumta; të bëjë rolin e ekspertit me shije të veçantë; t’ua mbushë mendjen të tjerëve se është djali i një burri të fisëm, që, nga modestia, refuzoi të shkruajë për të Historia në kapitullin e Luftës së Vlorës, ku, në fakt, nuk kishte qenë kurrë; të krenohet si baba i një djali të vogël, që gjoja merrej me kompozime veprash gjeniale muzikore.

Mbi supet e heroit emblematik të Dritëroit rëndojnë detyra me pesha të mëdha. Ai është kuadër i lartë që zbaton urdhëra partie, duke mos u bërë asnjë lajkë. Veprat e tij janë një për një në pajtim me parimet e sistemit: folklorizimin institucional të poezisë; kërkimin e modeleve të artit mes rapsodëve dhe kooperativistëve; detyrimin e krijuesve për t’u shkrirë e bërë një me popullin në kërkim të inspirimit; përkrahjen e krijimtarisë mesatariste e mediokre – pandehjen e saj si vezuf estetik; injorimin e krijuesve risimtarë; garat kulturore në ambiente rurale dhe në fshatra të thellë malësie; ndalimin e çdo kënaqësie përveç qejfeve kolektive; ndalimin e këngëve, hiq elozhet për oborrin mbretëror.

Për nga gjithdijshmëria, Zylua është i ngjashëm me doktor Adham-utin e Çajupit. Për nga marrëzia e madhështisë me Denizullu Serpen e Konicës. Ngado që sillet, Zylua ofron atë që ka me shumicë: budallallëkun. Ai e degradon vetveten kudo që hap gojën, ama, ka dhe një të mirë, që nuk mund t’i mohohet, sepse: hënë-hënë, kthjellohet, bën autokritikë dhe e quan veten gomar.

Demka, personazhi i dytë i rëndësisishëm i romanit *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* është shkrimtar, është nëpunës që varet nga eprori i tij Zylua. Tek ai mishërohen tiparet e mizërisë së mediokritetit. Ai është shpirtrob që s’i tutet asgjëje me shumë se lirisë. Ai ka frikë prej darëve drobitëse të pushtetit të hurit e litarit, që e ka shndërruar në kandër kafkiane, në qenie me mungesë dinjiteti, që e pranon përuljen si kësmet të pashmangshëm. Demka është i papersonalitet, kuadër i prerë për rapsod oborri. Është fatalist që nuk sheh rrugëdalje për ta ndryshuar situatën në favor të vetin. Është vegël në duart e Zylos, asgjë më shumë. Ai e di këtë, ndaj thotë: *“Më duket vetja si një nga ato bimët që jeton bashkë me një bimë tjetër. Kini parë disa bimë që përdridhen në trungun e një bime të dytë dhe lëshojnë ca si penj të vegjël në shëmbëllimin e rrënjëve. Po t’i ndash, njëra nga ato thahet...”*

Nganjëherë Demka “harron” të shkruajë edhe pse është 40 vjeçar dhe aq i pjekur sa për të pasqyruar pagabueshëm të vërtetat. Ai shkon në fshat të nxisë aktivitete kulturore, por atje harron përse ka shkuar dhe merret me vrasjen e një gomari, me banjon publike, me dervishin e fshatit. Ai është një shkronjë që, nën hijen e pushtetit dhe pushtetarëve, punon për të tjerët – shkruan raporte që i lexon tjetërkush. Më e keqja është se kjo është zeja e tij e përditshme dhe e rëndë, sepse duhet të shkruajë, jo për një, po për kabilen e madhe të pushtetarëve injorantë, të pushtetit që nëpërkëmb krijuesit dhe i shndërron ata në nëpunës administrate dhe qatipë të thjeshtë, në Sanço Pançë.

Demka është i shqetësuar, sepse dëshiron të shkruajë artikuj, tregime, vepra arti, sepse ka mundësi ta bëjë këtë. Ai nuk guxon t’u thotë padronëve se më nuk do t’u bëjë shkrime, edhe pse është i ndërgjegjshëm për katandisjen në kurgjë. Prandaj vazhdon t’i paguajë tagër të rëndë qyqarllëkut, duke u kthyer në vegël, në automat. Demka i gjoë pranon përunjshëm t’ia vë samarin i rrepti e i shqepti. Ai rrezikon që të sëmuret nga stërngarkimi, sepse s’ka kurajë të rrefuzojë porosinë si kolegu Adem Adashi, që shkruan për vete, jo për burokratët budallenj.

Ai po e shkon jetën nëpër zyrat e ministrive dëng me Zylo e Shemshedina të gjendur aksidentalisht në krye të institucioneve të kulturës, në sektorin e artit dhe letërsisë, që, aq sa kanë nevojë për ajër, kanë edhe për një Demkë. Madje, ata zihen ndërmjet tyre kush do ta lexojë raportin e shkruar nga Demka. Më e keqja është se ata paturpësisht pohojnë se japin mund për shkrimet të cilat ua përgatit Demka, sepse autorit i ofrukan të dhëna të përgjithshme rreth përmbajtjes së raportit. Kështu Demkë ziu – shkrimtari i papersonalitet e shpirtrob, skeptik e interesaxhi, frikacak e lojal, bërës kultesh e ode-xhi... i gëlltit edhe fyerjet e inteligjencës. Sa i mjerë, i gjithkohshëm e i kudondodhshëm është ky Demka ynë!

Antizhdanovizmi agollian

Po sjellim në vijim momentet e antizhdanovizmit agollian kundër ligësive të mirënjohura të sistemit - rrefuzimin e hapur pothuajse të të gjitha rregullave bazë të letërsisë pragmatike të realizmit socialist, të cilën e arriti nëpërmjet:

- emërtimit dhe talljes së heronjëve të pushtetshëm me emra qesharakë, të cilët, sipas udhëzimeve nga lart duhej të ishin pozitivë dhe me emra të bukur;
- talljes me direktivat që kërkonin paraqitjen sa më të bukur të jetës së njerëzve në vepra arti;
- talljes me titujt qesharakë të librave të preferuar nga ideatorët e pragmatizmit;
- lavdërimit të mediokriteteve që kanë shkruar artikujt e parë mbi metodën e realizmit socialist;
- ngritjes së rapsodëve në model krijuesish;
- disiplinimit të redaktorëve/ botuesve të padëgjueshëm;
- folklorizimit të letërsisë;
- pasojave që binin mbi ata që anashkalonin mësimet e partisë;

- epërsisë së mençurisë së fshatarëve në raport me kuadrot e lartë të kulturës së vendit;
- ndërhyrjes së përgjegjësve injorantë të kulturës në redaktim veprash letrare;
- imazhit prej kllouni të zyrtarëve të kulturës përpara njerëzve të thjeshtë;
- krahasimit që i bën Zyloja vetvetes me kafshët;
- mendjemadhësisë së pushtetarëve;
- karikaturimit të hapur të kulturës masive;
- censurimit të folklorit prej përgjegjësve të kulturës;
- persekutimit të artit;
- përmendjes së tmerreve moniste dhe dënimeve/ persekutimeve të krijuesve;
- talljes me epërsinë falce të stalinizmit ndaj kapitalizmit etj., etj.

Receptimi i romanit

Romanin e Dritëro Agollit të vlerësuar gjithandej si: *autor me përmasa evropiane që meriton famë ndërkombëtare; autor që pasuroi letërsinë botërore me një satirë verbuese dhe brilante, që kritikoi ashpër burokracinë e vendit të tij...*, në disa pika, e shoh si zgjatim të esesë së famshme të Konicës, *“Shqipëria si m’u duk”* dhe veprës së famshme të Erazmo Roterdamit *“Lavdërim marrisë”*. Është libër që sigurisht do të mbijetojë shekujt, sepse ka prekur një fenomen të gjithkohshëm dhe të kudondodhshëm. Këtë bindje e kanë dhe njohësit e letërsisë evropiane, për të cilët romani i Agollit është me vlera universale, me stil dhe trajtim mjeshtëror të ngjarjeve.

Disa studiues *“Shkëlqimin dhe rënien e shokut Zylo”* e lidhin me traditën e veprave të mëdha satiriko-humoristike. Sipas tyre, ai është: *libër i habitshëm, satirë e tmerrshme për absurditetin e burokracisë dhe shtetit, roman i mprehtë djallëzor, i ngjashëm me veprën “Shoka e grave” e Andre Zhidit, me “Revizorin” e Gogolit, me veprat e Çehovit, Kafkës, Solzhenicinit.*

Në shkrimin *“Shoku Zylo është tepër i zellshëm”*, të boruar në revistën franceze *“Lë Nuvel Observatër”*, më 18 korrik 1990, studiuesi Dominik Fernandez, tha: *“Ç’fat më i shkëlqyer mund t’i caktohet një heroi romani se sa të përdoret në jetën e përditshme, si një emër i përgjithshëm? Këtë fat të lavdishëm e ka pasur ushtari Shvejk dhe Ati Ubu. Tanimë, shoku Zylo do të kompletojë triologjinë e këtyre groteskave prekëse që zbulojnë sklerozën dhe budallallëkun e një sistemi”*.

Një vlerësim të denjë për të nderuar çdo krijues të madh të botës e bëri studiuesi belg Pierr Morrij. Në artikullin *“Shkrimtari shqiptar Dritëro Agolli kritikon ashpër burokracinë e vendit të tij”*, të botuar në gazetën *“Le Soir”*, më 27 qershor 1999, ai shkroi: *“Nuk ka asgjëkundi kritikë më të ashpër të organizimit në vendet e Lindjes sesa në këtë libër, ku mekanizmat e pushtetit çmontohen me një egërsi; të zbutur disi nga një ndjenjë humori, që i afron personazhet me ne, që i bën ata kukulla të manipuluar nga një sistem që është aq i “perfeksionuar” sa nuk mund t’u lë atyre një liri të madhe veprimi”*.

Vlerësime interesante janë bërë edhe për Zylo Kamberin, ndoshta heroin më të njohur dhe më atipik në gjithë letërsinë shqipe, të cilin kritikët e krahasuan me Don Kishotin e Servantesit, me Jeromilin e Milan Kunderës dhe me Ushtarin e mirë Shvejk të Hashekut. Këtë hero njëkohësisht *komik dhe jetësor, të tallur dhe tallës...*, Dritëroi e pavdekësoi dhe e kaloi në mit. Sikur e parandjeu se asnjë kohë nuk është pa Zylot e saj.

Literatura:

- [1]. Agolli Dritëro, *Shkëlqimi dhe rënja e shokut Zylo*, Rilindja, Prishtinë 1990.
- [2]. Sinani Shaban, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë 2010.
- [3]. Aliu Ali, *Fenomeni Zylo në prozën e Dritëro Agollit*, Zemra Shqiptare, 2010.